

Arti politika biologjia dhe "kodi" i Da Vincit (II)

Biopolitika e simboleve

Nga Qamil Gjyrezi

Gjithashtu *energja*, që është aktivitet, veprim, punë a nuk është e lidhur me biologjinë dhe mbi të gjitha me artin, politikën, shenjën semiotikën, muzikën, si p.sh. format energjisë kinetike, potenciale, termale, elastike, tingulli, drita, etj, *energja për të qenë dhe për të bërë* që është Arti, muzika dhe politika ose semiotika, *energja për të krijuar dhe kërkuar në fusha të ndryshme*. Frojdi shkruan se *ndjenjat* janë harxhime të *energjisë*, ekspresioni final i të cilës perceptohet si *sensacion*. (Vygotskij, 1925) Dhe diku tjetër vazhdon: "*Shndërrimi i energjive lëvizëse psikike në forma të ndryshme të veprimtarisë ndoshta janë po aq i pamundur pa humbje, si edhe shndërrimi i forcave fizike*". (Frojd 2005). Leonardo është quajtur *Fausti Italian*, për nga pangopshmëria e pasionit të humlumtuesit. Në *biologji* gjithashtu *evolucioni* është ndryshim në materialin gjenetik të një popullsie të organizmave nëpërmjet gjeneratave të mëparshme. Pikërisht ky fenomen ka edhe rolin e tij në evolucionin artistik, muzikë dhe politikë që bën lidhjen e biologjisë me *bioartin* e *bipolitikën*. Ekologjia ka lidhje të forta me artin. Por këtë temë do ta trajtoj më gjërë në një artikull të vecantë. Ekologjia studion përhapjen dhe pasurimin e organizmave të gjallë dhe ndërveprimin ndërmjet organizmave dhe ambientit të tyre. Biologjia është e lidhur me ekologjinë, gjithashtu ekologjia lidhet me artin, politikën dhe semiotikën. Ekologjia merr një rëndësi të vecantë në vendet e zhvilluara. Arti dhe ekologjia kanë një zhvillim të paparë në botën moderne, vepra arti të bëra me element ekologjikë, përshtatje, mbetje të industrisë, muzika është e lidhur me ekologjinë, muzika *futuriste* e kompozitorit Gregory Kurtag, muzikimi i perceptimit të natyrës dhe harmonizimi dhe ritmimi i tij. Arti muzikorë krijohet mbi impresionin dhe perceptimin e natyrës dhe ekosistemit, *tinguj natyralë dhe futuristë*. Biomuzika dhe arti dhe ekologjia, muzika *etnike futuriste* e Goran Bregovic, Bobo Markovic, Ceca, Hisnia Rexhepova, Japonezë që interpretojnë mitikën, semiotikën zakonet japoneze budiste, idiane që lozin muzikën e tyre dhe zakonet e tyre, psikologjia indiane, artet marcialle dhe fisi Tambuka nga Afrika, Bantu, që shërojnë me muzikën e tyre nëpërmjet një *bioenergji* ose një *biomendje*. Fisi Tambuka, fermerë, kërcen një "ekzistencë autentike" një hapje drejt të "Qenurit", e cila duhet të kuptohet në e statusin e tij *ekzistencial*, si mënyrë e të qenurit në këtë botë, element *biosemiotik*. Ky lloj arti ose *bioarti*, *semiotika cognitive* është një kurë e vertetë mendore, një gjuhë jo-verbale e cila kuron dhe ka edhe *shenjën* e vet identifikuese. Një punë e mrekullueshme *ekoarti* e Muhamet Trepcit është "*Me emocionet e nanës natyrë*", që do trajtoj në një artikull të vecantë e lidhur me artin dhe ekologjinë, *bioartin*, *biosemiotikën*, *ekosemiotikën* dhe *bioekologjinë*. Trepci ishte artisti i parë që, si pasojë e formimit të tij intelektual, semiotik politik dhe social na dha një shembull identik, për *ekosemiotikën* dhe *biosemiotikën* ose për *ekoarti* dhe *bioartin*. Me librin dhe punët e tija për lidhjet e natyrës me artin, ai është krijuesi i kësaj rryme në Shqipëri dhe punët e tija janë vepra të mirëfillta arti, pasi është shenja e tij, forma e të menduarit virtual, tredimensionale dhe shenjore, eksperienca e tij, që krijuan këtë art ose *ekoarti* i lidhur me bioartin dhe bio politikën. Punët kanë edhe vlera estetike por mbi të gjitha komunikative. Muhamet Trepci punoi dhe vazhdon të punojë me drurin e ullirit, dhe gjatë punës

gjeti disa *ekofigura* ose *biofigura*, të cilat janë *vepra të mirëfillta arti* dhe shenja të lidhura me *ekosemiotikën*, që është edhe imagjinata dhe imagjnario e tij, ose *Uni* i tij tashti të kthyer në art. Muhamet Trepci është njeriu i parë në botë që e bën këtë punë të rrallë artistike. Zogu është simbol, arketip, metaforë dhe mbi të gjitha *shenjë*, por ai është dhe *imagjinatë* dhe formë të menduarit, prandaj edhe autori e ka "gjetur", se është pikërisht zogu që është krijuar në imagjinatën e tij, simboli i lirisë dhe i fluturimit, që ka qenë dhe është ëndrra e gjithsecilit, gjithashtu edhe e autorit. Prandaj autori kërkoi ti referohej *rastësisë*, *spontanitetit* kur shkruan duke ju referuar Pikasos se: "*Unë nuk kërkohet por gje*"! Punët e Trepcit mund t'i studjojë arti, psikologjia (mbasi janë edhe studime rasti), sociologjia, antropologjia, epistemologjia, etj.

Muzika ka lidhje edhe me biologjinë.

Biomuzika është formë e muzikës eksperimentale e cila ka të bëjë me tinguj të krijuar ose të luajtur nga qenjet e gjalla ose përfshin tinguj të bërë nga qenjet njerëzore në formë direkte biologjike. p.sh muzika e krijuar nga *sinjalet e trupit* të kompozitorit direkt me rrugë biologjike e quajtur *biomuzikë*, sic mundet të quhet biomuzikë, muzika e krijuar nga trupa njerëzore pa përdorimin e mjeteve dhe instrumentëve që nuk janë pjesë e trupit (të kënduarit ose vokalizimi janë të përjashtuar nga ky përcaktim). Biomuzika është e ndarë në dy kategori: muzika e krijuar vetëm nga kafshët (ose në disa raste nga bimët) dhe muzika e cila mbështetet në zhurmat e kafshëve dhe që orkestron nga një kompozitor. Muzikanti Francesco Balilla Pratella, ju bashkua lëvizjes futuriste në 1910 dhe shkruajti "*Manifestin e muzikës futuriste*". Pratella kritikoi muzikën italiane të kohës si inferiore, vlerësoi shumë Wagnerin, shikonte disa vlera tek muzika e Debussy dhe Richard Strauss. Pratella në atë kohë vlerësoi Mascagnin, por edhe ai ishte shumë tradicional, për shijet e Pratellës. Kështu *manifesti* i Pratellës ishte një "lëvizje artistike" për artin e muzikës. Ai pretendonte për ndryshime radikale në artin e muzikës të kohës. Pratella artin e zhurmave e kalsifikoi në "*tingull-zhurme*" në gjashtë grupe: Britma, Eksplozioni, Shpërthime/Vërshëllima, Shfryrje/Përshpëritjet, Mërmëritje, Gurgullima/Kërcitjet, Klithmat/Zhurmat e situara nga rrahja e metaleve, drurit dhe gurit/Zërat e kafshëve dhe njerëzve, Piskamen, Ulëritjen, Kujën. Semiotika është procesi ose shkenca e studimit të shenjave (*semiosis*) ose kuptimi dhe komunikimi i shenjave dhe simboleve. *I gjithë shenja njerëzore është "gjuhë"*. Semiotika është një dukuri *qoftë kulturore ashtu dhe biologjike*. Për të vertetuar këtë thënie po i referohem shkrintares Julia Kristeva, e cila spjegon kuptimin lingvistik, biologjik dhe semiotik të qenies: "Qenia është *strukturë kuptimi*, ajo paraqet lidhjet e saj folëse në marrëdhënie me të tjerët. Për këtë motiv, ajo kap një vlerë terapeutike dhe morale. Duke garantuar përgjigshmërinë e individit të frymuar ndaj trupit të tij, ajo i vidhet kësaj *fatalitetit biologjik* dhe shndërrohet në cilësinë e *trupit folës*". (Julia Kristeva, Luan Topciu, 2010).

Biosemiotika (biologji, gjallesat, shenjat)

Biosemiotika ose e quajtur ndryshe "jeta



(gjallesat)shenjat", ose "shenja si gjë e gjallë", në fakt është "gjë e gjallë", mbasi jemi neve që e krijojmë dhe e materializojmë (*Empatia*), është një fushë që po rritet dhe studion produktin, veprimin dhe interpretimin e shenjit në botën biologjike. Biosemiotika tenton të integrojë gjetjet e biologjisë shkencore dhe semiotikës, të pikpamjes shkencore perëndimore të jetës (*kuptimin dhe interpretimin* e shenjës). Termin e ka përdorur i pari *Friedrich S. Rothschild* në vitin 1962. Semiotika është procesi (shkenca) i studimit të shenjave (*semiosis*) ose kuptimi dhe komunikimi i shenjave dhe simboleve. Ka argumente të fortë, që muzika zën një botë *semilogjike*, e cila në të dyja, *nivelin ontogjenetik (origjinën dhe zhvillimin e një organizmi, fertilizimi-maturimi)* dhe *filogjenetik (studimin e lidhjeve evoluzioniste, ndërmjet grupeve të ndryshme të organizmit, p.sh. speciet dhe popullsitë)*, ka një prioritet mbi gjuhën verbale" (Middlton, 1990, 172).

Muzika transmeton shpesh, më shumë se gjuha e shkruar dhe e folur, e rëndësishme është të kuptosh mesazhin dhe ti gesh kodin, ta *dekodosh* *signifikatin*, "kuptosh" artin muzikorë. Kurse Bioarti është një praktikë artistike, në të cilin mjedisi është një vend jetese dhe punët e artit janë prodhuar në laboratore dhe studio e artistëve. Mjeti është *bioteknologjia*, e cila përfshin teknologji të tilla si *inxhenjia gjenetike, kultura e indit dhe klonimi*. Mjetet që përdorë *bioarti* janë qeliza, DNA, proteinat dhe indet e gjalla. Frazja *Bioarti* është përdorur nga Eduardo Kac në 1997. Bioarti konsiderohet si lëvizja e parë artistike për shekullin e 21të.

Biopolitika dhe semiotika

Termi *biopolitikë* (biofuqi, fuqi-qeverisëse) dhe *biopolitik* ju referohehet disa koncepteve të ndryshme: *Në punën e Michael Foucault, stili i qeverisë që rregullon popullsinë nëpërmjet*

biofuqisë (aplikimit dhe impaktit të fuqisë politike në të gjitha aspektet e jetës shoqërore.) Politika ka fuqi sot në të gjitha aspektet e jetës shoqërore, ekonomi, infrastrukturë, art, zhvillim, tregëti, finanza, media. Është pikërisht kjo *biofuqi* që ka sjellë këtë zhvillim dhe padyshim "*ka sjellë*" edhe krizë botërore ekonomike dhe finansiare. *Biofuqia "krijoi"* krizën globale ekonomike, për të krijuar një sistem bankarë të ri dhe ekonomi të re për "*Mileniumin e ri*". A nuk ishte *biofuqia* që sulmoi bishën serbe gjatë krizës së Kosovës, ku biofuqia krijoi një *gjeopolitikë* të re rajonale. *Në punët e Michael Hardt dhe Antonio Negri, kryengritja anti-kapitaliste duke përdorur jetën dhe trupat si armë; shembuj përfshijnë largim nga fuqia dhe, 'në formën më tragjike dhe revoltuese' terrorizmin vetëvrasës. Konceptualizuar si fuqi e biofuqisë, e cila është parë si praktikë e sovranitetit në kushtet biopolitike.*

-Avokatia politike në mbështetje të, ose në opozitë të aplikimeve dhe bioteknologjisë.

-Politikat publike që kanë të bëjnë me disa aplikime dhe bioteknologjinë.

-Avokatia politike që ka të bëjë me të mirëqenien dhe të gjitha format e jetës. (Wikipedia) Më ka bërë përshtypje një punë "Prima della sonata" e Carls Ives, muzikantit amerikan, antropologut dhe studjuesit të shenjave, që mendoja se kishte të bënte me artin por në fakt ishte një punë që gërshetonte *bioartin (sulet trurorë të artit të Bethovenit)* me *biotikën*, pasi muzikanti i madh Ives, kishte mik i disa politikanëve të njohur në Amerikë dhe kuptonte rolin e politikës në art të cila trajtonte si *bioart* ose *art futurist* dhe fuqitë e kësaj bioarti në *biopolitikë* dhe në *politikë* *bale*. Puna bënte fjalë për një "Sonatë" kompozitorit të madh gjerman *Bethoven*, që *bioart* në punët e tij, shekuj përpara *biomendjen* e tij, ai i shurdhër i la njerëz art të pavdekshëm

Vijon në numrin e ardhës